

I. HYRJE.

Subjekti DUKA sh.p.k është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti J77411203S.

Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: Fera e Xhikës, Bashkia Vlorë.

Objekti i veprimtarisë së subjektit është: “Prodhim të materialeve të ndërtimit, ndërtime e shtrime rrugësh, punime dhe gërmime me makina të rënda, punë rrugësh dhe digash, shtrimesh, ndërtimit, servis makinash, pjesë këmbimi dhe çdo lloj tjetër punimi objektiv Shërbime komunale të të gjitha llojeve. Tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimore, etj. Diferencim, riciklim i mbeturinave urbane. Vlerësim i ndikimit dhe impakti në mjedis, auditim dhe ekspertizë mjedisore, studim, projektim dhe zbatim të projekteve mjedisore. Transport për vete dhe për të tretë. Qiradhënie dhe Qiramarrje”.

Administratori i këtij subjekti është z. Adhurim Duka.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me:

ID 3.1/e Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të betonit. (Kapaciteti prodhues: 120 m³/orë)

ID 3.10 Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike.

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundëshme në mjedisin e punës dhe në afërsi të tij si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtuar shëndetin e punonjësve si dhe, pa i sjellë dëme mjedisit të zonës si:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshëm i kësaj veprimtarie, vlerësuar nga pikëpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit, është rezultat i disa faktorëve, të cilët janë vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlerësimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subjekt.
- Njohja e gjendjes reale e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitivë dhe negativë, që influencojnë në treguesit mjedisorë.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.

- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar).
- V.K.M. nr. 435, datë 12.09.20020 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- V.K.M. nr.177, datë 31.03.2005 “për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- V.K.M. nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- V.K.M. nr. 587 datë 07.07. 2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subject te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB”.
- V.K.M. nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin diferencuar të mbetjeve në burim”.
- V.K.M nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- V.K.M. nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- Urdhri e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

III. INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ.

3.1. Vendi ku zhvillohet veprimtaria.


Objekti i prodhimit të betonit në të cilën zhvillon veprimtarinë e tij, subjekti DUKA sh.p.k., gjendet në vendin e quajtur Fera e Xhikës, Bashkia Vlorë, në një shesh ndërtimi në pronësi të firmës DUKA sh.p.k. Në këtë bazament me sipërfaqe 2000 m² kemi këto kufizime:

Nga veriu: Kullotë

Nga perëndimi: Zonë e lirë

Nga jugu: Zonë e lirë (rruga)

Nga lindja: Kullotë



Objekti është i plotësuar me infrastrukturën e nevojshme inxhinjerie, në bazë të projekteve përkatëse, të miratuara që në lejen e ndërtimit.

i. Infrastruktura e furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Energjia elektrike e nevojshme merret nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike të zonës, në bazë të kontratës përkatëse me OSSHE e kësaj zone. Energjia e nevojshme për këtë linjë prodhimi është siguruar nga rrjeti 10 kw i siguruar nga ish instalimet e duke siguruar fuqinë e instaluar rreth 110 kw. Energjia elektrike përdoret kryesisht për ndriçimin e ambjenteve të punës, rrugëve etj.

ii. Infrastruktura e furnizimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm.

Nevojat për ujë në linjë e këtij lloji ndeshen vetëm në sektorin e përgatitjes së betoneve si dhe për nevoja sanitare, siç u tha dhe më lartë kjo sasi uji është siguruar nëpërmjet linjës të ngritur nga pusi i shpimit deri tek sektori i prodhimit me një prurje rreth 5 m³/orë, sasi e nevojshme për nevojën e prodhimit. Cilësia e këtij uji është ujë i filtruar. Për të siguruar ujë të vazhdueshëm në rast avarish është siguruar një depozitë rreth 50 m³ që përdoret reserve që ky cikël të mos ndërpritet.

iii. Përdorimi lëndës djegëse, naftë.

Të gjitha mjetet që punojnë në këtë karrierë punojnë me lëndë djegëse naftë. Ajo blihet në subjekte të liçensuar për magazinimin dhe tretimin e saj. Konsumi naftës shkon mesatarisht në rreth 350 litra/muaj.

3.2 Përshkrimi i proçeseve teknologjike

KARAKTERISTIKAT KRYESORE

Materiali: Beton të markes 200-250-300-350 dhe 400 për ndërtim

Produkti përfundimtar: Betoni i markave të ndryshme

Kapaciteti prodhues: 120 m³/orë

Fuqia e instaluar: 110 kw

Sipërfaqja totale e sheshit të ndërtimit: 4500 m²

Sipërfaqja e linjës: 2000 m²

Proçesi i prodhimit dhe karakteristika e tij

Linja e prodhimit të betonit përbëhet nga:

1. Mure betoni dhe rruga për mbushjen e bunkiereve
2. Fusha e depozitimit të inerteve
3. Depozitat e ujit 50 m³
4. Depozitat e inerteve, bunkieret (5x50 m³)
5. Prerja e inerteve
6. Transportieri
7. Depozitat e çimentos (2x60 ton)
8. Përzieri i materialit (mikseri)
9. Salla e komandimit
10. Kompresori 500 litërsh
11. Kabina elektrike
12. Parkimi I automjeteve, ku në pronësi ka: autobetoniere 4 copë, 1 pompë, bote çimentoje 1 copë, makina vetshkarkuese 2 copë, sipërfaqe e gjelbëruar.

Qëllimi i prodhimit të betonit të linjës së betonit dhe karakteristikat fizike të këtij projekti.

Kjo linjë ka për qëllim të realizojë prodhimin e betonit të markave të ndryshme. Ky prodhim që përdoret në industrinë e ndërtimit sin ë objektet sociale dhe ato industriale është i markave të ndryshme: marka 200, marka 250, marka 300, marka 350 dhe marka 400. Këto lloj marka betony përdoren në lidhjen e elementëve të veçantë si tulla, blloqe betoni, gurje artificial, pllaka poroze dhe jo poroze të çdo lloj dimensiononi duke ruajtur cilësinë ndaj sizmicitetit si dhe ndaj ujërave sulfate të cilat shkaktojnë dëmtimin e betonit të markave të ndryshme. Po kështu cilësia e betonit duhet të jetë e tillë që ti rezistojë temperaturave dhe agjentëve atmosferik. Në këtë linjë janë punësuar rreth 15 punonjës të cilët janë marrë në bashkëpunim në komunitetin aty afër në të cilën po kryhet aktiviteti. Në këtë personel përfshihet personeli administriv dhe ai Teknik i kualifikuar.

KARAKTERISTIKAT E LINJËS DHE SKEMA E PROÇESIT TË PRODHIMIT

Karakteristikat dhe sasia e lëndëve të para ndihmëse

Produkti i gatshëm që do të prodhohet është betoni i markave të ndryshme. Në fillim është një përzierje rërë zall i përmasave të ndryshme dhe të përqindjeve të ndryshme të cilave u hidhet ujë dhe me autobetoniere bëhet përzierja derisa të vejë tek konsumatori. Çertifikata e analizave të këtyre lëndëve tregon se këto lëndë plotësojnë standartin teknik të përdorimit në industrinë e materialeve të ndërtimit për prodhimin e betoneve përdoret ose gur gëlqeror i bluar ose lëndë inerte të përpunuara në linjat e inerteve të mara nga lumenjtë.

Kur përdoret gur gëlqeror i bluar kemi këto përbërje kimike:

Sipas vendburimeve të gëlqeroreve % e elementëve është si më poshtë

CaO – 54.5 %

MgO – 0.45 %

Fe_2O_3 – 0.4 %
 P_2O_5 – 0.025 %
 Al_2O_3 – 0.10 %
 SiO_2 – 0.5 %
 SO_3 – 0.02 %
 HK – 41.8 %

Analizat e rërës së fraksionit të imët që përdoret në këtë proces teknologjik ka këto tregues:

Pesha specifike 2.58-2.6

Lagështia varion sipas stinëve deri 12 %

Aciditeti dhe alkaliniteti (pH 6-6.5)

Fortësia 900-1350 kg/cm²

Përsa i takon analizave të përbërjes së çimentos, çdo prodhim çimentoje blihet me certifikatën e saj brenda standarteve sipas markave të betonit.

Ky proces është një përzierje rërë guri i coptuar të përmasave të ndryshme të cilëve u shtohet uji dhe çimentoja kur nëpërmjet autobetonieres siç e theksuam më lart bëhet përzierja derisa të vejë tek konsumatori.

Për betone mbi bazë guri janë këto përzierje. Betoni është i markave të ndryshme. Betoni i markës 200.

Betoni i markës 300

Çimento tipo kg/m ³	çimento 42.5II/Al	Pesha 381
Diametri maksimal mm		31.5
Agregati	%	Sasi në peshë
Rërë guri	45 %	768 kg/m ³
Granil 0.5-10 mm	14 %	225 kg/m ³
Granil 10-20 mm	41 %	662 kg/m ³
Sasia e ujit të përgjithshëm		251 l/m ³
Raporti ujit çimentos (a/c)		0.66
Pesha specifike e përzierjes		2.287 kg/ m ³
Klasa e konsistencës		S5

Betoni i markës 350

Çimento tipo	çimento 42.5II/Al	Pesha 417
kg/m ³		
Diametri maksimal		31.5
mm		
Agregati	%	Sasi në peshë
Rërë guri	44 %	736 kg/m ³
Granil 0.5-10 mm	14 %	220 kg/m ³
Granil 10-20 mm	42 %	665 kg/m ³
Sasia e ujit të përgjithshëm		251 l/m ³
Raporti ujit çimentos (a/c)		0.6
Pesha specifike e përzierjes		2.289 kg/ m ³
Klasa e konsistencës		S5

Betoni i markës 400

Çimento tipo	çimento 42.5II/Al	Pesha 455
kg/m ³		
Diametri maksimal		31.5
mm		
Agregati	%	Sasi në peshë
Rërë guri	43 %	704 kg/m ³
Granil 0.5-10 mm	14 %	216 kg/m ³
Granil 10-20 mm	43 %	666 kg/m ³
Sasia e ujit të përgjithshëm		251 l/m ³
Raporti ujit çimentos (a/c)		0.55
Pesha specifike e përzierjes		2.292 kg/m ³
Klasa e konsistencës		S5

Në betone mbi bazën e inerteve të limit të përpunuara në linjat e inerteve.

1. Marka 100-1 ton (rërë 40%, zhavor 60%) + 220 kg çimento
2. Marka 150-1 ton (rërë 40%, zhavor 60%) + 268 kg çimento
3. Marka 200-1 ton (rërë 40%+zhavor 60%) + 288 kg çimento
4. Marka 300-1 ton (rërë 40%+zhavor 60%) + 350 kg çimento

Energjia e nevojshme për këtë linjë prodhimi është siguruar nga rrjeti 10 kw i siguruar nga ish instalimet e duke siguruar fuqinë e instaluar rreth 110 kw.

Nevojat për ujë në linjë e këtij lloji ndeshen vetëm në sektorin e përgatitjes së betoneve si dhe për nevoja sanitare, siç u tha dhe më lartë kjo sasi uji është siguruar nëpërmjet linjës të ngritur nga pusi i shpimit deri tek sektori i prodhimit me një prurje rreth 5 m³/orë, sasi e nevojshme për nevojën e prodhimit. Cilësia e këtij uji është ujë i filtruar. Për të siguruar ujë të vazhdueshëm në rast avarish është siguruar një depozitë rreth 50 m³ që përdoret reserve që ky cikël të mos ndërpritet.

Skema teknologjike e prodhimit të betoneve.

Prodhimi i betonit është një proces zinxhir që realizohet në linjën përkatëse teknologjike të importuar si linjë e përdorur prodhuar nga firma Italiane.

Kjo firmë prodhuese e makinerive kryesore të linjave të prodhimit të betoneve njihet si firmë prestigjioze në mbarë Europën.

Konkretisht linja të tilla që ka montuar firma DUKA sh.p.k janë montuar nga specialistë të specializuar për montimin e këtyre linjave. Në bazë të makinerive të zgjedhura dhe skemës së zbatuar kemi besim se kjo linjë do të konkurojë denjësisht në treg duke realizuar prodhimin e markave të ndryshme të betonit sipas kërkesave në teknologjinë e ndërtimit. Për të patur një garanci për cilësinë e betoneve dhe për mbarëvajtje aktiviteti kjo firmë mendon që në të ardhmen të ngrejë një laborator për analizën e prodhimeve të kësaj linje.

Skema e funksionit të linjës së prodhimit të betonit.

Lënda e parë (guri gëlqeror i bluar ose inerte lumore të përpunuara), çohen në bunkeret përkatëse për materiale inerte të ndara në bokse të ndryshëm me 4 dimensione: për rërë 0-2 mm, fraksioni 5-10 mm, fraksionin 10-20 mm. Bokset e inerteve kanë një kapacitet 5x50 m³, prej këtej këto fraksione kalojnë në peshoren elektronike për realizimin e recepturave sipas markës së betonit të prodhuar.

Nga peshorja elektronike materiali kalon në përzierësin i cili siguron përzierjen uniform të materialit të future. Këtu nëpërmjet shnekut të çimentos shtohet sasia e çimentos duke peshuar 5000 kg, të komanduara sipas recepturave përkatëse të markave të betoneve të ndryshme. Linja ka dy sillosx60 ton për depozitimin e çimentove sipas markës së dhënë më lartë. Me ndihmën e shnekut të hermetizuar kalon në autobetoniere e cila xhiron me rreth 60 rrotullime në minutë ku finalizohet produkti bojaku uji+çimento. Uji merret nga rezervuari me linjën e rregullt me sistem komandimi ku sasia e ujit të nevojshëm matet me kontaliter aparat matës së sasisë së ujit në litra. Pas përgatitjes së kësaj përzierjes me xhiro maksimale të autobetonieres hidhet materiali inert me komandim për hapjen e bukaportave të boskeve të peshores të materialeve inerte sipas recepturave që kërkon marka e betonit. Gjithë sistemi i transportit të materialit, përzierjes dhe pushimit është një sistem automatik i cili sigurohet nga vetë konstruksioni i pajisjeve që përbëjnë këtë linjë teknologjike.

Skema e furnizimit me çimento.

Kjo linjë është mjaft e thjeshtë dhe realizohet nëpërmjet instalimit të dy sillosit i cili furnizohet nëpërmjet autocisternave që transportojnë çimento. Prej këtej ajo me anë të shnekut transportohet për të peshuar dhe për tu përzier me lëndë të tjera (gur gëlqeror ose inerte) për të prodhuar markën e betonit të kërkuar nga klientët. Në linjën e prodhimit është instaluar dhe linja e prodhimit të ajrit të komprimuar për pneumotransportin e çimentos nga sillosi. Autobetonieret (2 copë) janë në gjendje të mirë teknike dhe nuk derdhin asnjë lloj materiali në rrugë. Në pistën e depozitimit të materialeve inerte është instaluar një linjë uji për spërkatje për të mos lejuar ngritjen e pluhurave në ajër gjithashtu kjo firmë ka dhe 1 pompë betoni.

IV. Lëndët e para dhe ato ndihmëse.

4.1. Lëndët e para.

Lëndët e para për prodhimin e betoneve të markave të ndryshme janë të njohura dhe të përdorura nga subjekte të cilët kanë fushë të veprimtarië së tyre prodhimin e betoneve të markave të ndryshme.

Betoni përmban tre lëndë bazë, granilet/inertet, çimenton dhe uji.

Treguesit cilësor të sejcilës prej këtyre lëndëve si dhe raportet sasisore të përzjerjes së tyre, krijojnë betone me tregues cilësor të përcaktuar. Përdorimi i shtesave të caktuar përmirëson këto tregues cilësor.

Të dhënat përkatëse të literaturës së prodhimit të betoneve si dhe ato që rezultojnë nga eksperiencia e deritanishme e vetë subjektit, tregojnë për këto raporte sasiore mesatare të përbërësve të markave të zakonshme betoni. Propocioni mesatar i çimentos: rërës: çakëllit (gurin e grimcuar) është 1.0: 2.1: 4.2. Sasia e ujit është rreth 10 % e peshës totale të këtyre përbërësve, duke llogaritur këtu edhe sasinë e ujit sipërfaqësor që mbajnë inertet e përdorur. Për 1 m³ beton kemi rreth 270 kg çimento M400 + 544 m³ rërë + 11087 m³ zhavor + 210 m³ ujë.

a) Agregati/mbushësit (rëra me zhavorrin ose çakalli).

Agregati është komponenti më i përfaqësuar në masën e përgjithshme të betonit (75-80%). Sipas vetive fizike dhe kimike të tij ai nuk është material inert për arsye se ka ndikim në vetitë fiziko-kimike të betonit. Për përgatitjen e betonit shfrytëzohet agregat me prejardhje të ndryshme – natyrore dhe artificiale, siç janë:

- **Agregat natyror** (rërë, çakall dhe grimca / kokrra).

Agregati natyror – rërë dhe çakall nxirret nga shtretërit e lumenjve dhe përrenjve afër brigjeve të tyre. Kokrrat e këtij agregati natyror janë kryesisht të rrumbullakuara si pasojë e transportit më shpesh bashkë me ujin dhe erozionit, që ndikon në mënyrë të volitshme në përpunueshmërinë dhe vendosshmërinë e betonit.

- **Agregat i grimcuar ose i bluar**, i fituar me grimcim të shkëmbinjve gëlqeror monolit ose të palidhur.


Agregati i grimcuar, fitohet me grimcimin e shkëmbinjve natyror të fortë prej cilësdo prejardhje. Kokrrat e agregatit të grimcuar janë me tehet të mprehta çka mundëson inkastrim të tyre më të mirë dhe kjo kontribuon për përmirësimin e disa karakteristikave mekanike të betonit. Vetë e volitshme e agregatit të grimcuar është edhe homogjeniteti petrografik i tij ç'ka kontribuon që t'i shmanget ose zvogëlohet koncentrimi i sforcimeve në beton nga veprimi i ngarkesave ose ndryshimeve të temperaturave.

- **Agregat artificial** i fituar nga materiale të mbetura të ndryshme dhe prodhime –anësore industriale (mbeturina nga hiri i teceve, skorjet metalurgjike, materiale vullkanike etj.);

- **Agregate speciale**, siç janë: kermaziti, perlit i ekspanduar, materiale me fije të ndryshme etj.



rërë, çakall dhe grimca / kokrra



agregat i grimcuar i shkëmbinjve gëlqeror

Mes vetive fizike-mekanike më të rëndësishme ndaj të cilave duhet të kemi kujdes për çdo njerin prej llojeve të agregatit janë:

- Forma dhe pamja e sipërfaqes të kokrrizës së agregatit,
- Përmbajtja e grimcave të imëta në agregat,
- Përmbajtja e grimcave të lehta në agregat,
- Mbështjellja e sipërfaqes të kokrrave të agregatit,
- Përmbajtja e materieve organike në agregat,
- Prania e silicit amorf në agregat,
- Masa vëllimore e agregatit,
- Qëndrueshmëria e agregatit,
- Përbërja granulometrike e agregatit etj

Për arsye se për përgatitjen e betonit më shpesh shfrytëzohen kokrra kompakte, lagështinë e agregatit në masë më të madhe e përbën uji, i cila mbahet/gjendet në sipërfaqen e kokrrave. Lagështia sipërfaqësore, në varësi nga sipërfaqja specifike e agregatit mund të lëvizë deri 10%. Lagështia e agregatit duhet të përcaktohet para përdorimit të tij, për shkak të përcaktimit të sasisë të ujit që duhet t'i shtohet gjatë përgatitjes së betonit.

4.2. Lëndët ndihmëse.

Mjetet lidhëse kanë për detyrë t'i lidhin pjesët nga agregati në një komponent të tërësishëm. Si mjet lidhës mund të shfrytëzohen të gjitha llojet e çimentos, gëlqeres ndërtimore, gipsit, asfaltit, lloje të ndryshme të polimerive e tjera.

Çimentoja është mjet lidhës hidraulik i cili në kombinim me ujin transformohet në brumë të çimentos, i cili gjatë kohës ngurtësohet. Në varësi nga përbërja dhe mënyra e përpunimit ekzistojnë më shumë lloje të çimentos, por më së tepërmi përdoret i ashtuquajtur **portland-çimento**.

Çimentot grupohen në klasa të cilat shënohen me numrat 25, 35S, 35B, 45S, 45B dhe 55 ku janë:

- S – çimento me rritje më të ngadalësuar të qëndrueshmërisë.
- B – çimento me rritje më të shpejtë të qëndrueshmërisë.

Me përzjerjen e portland-çimentos dhe ujit fitohet brumë prej çimentos–pastë e cila gradualisht fillon të lidhet dhe ngurtësohet gjatë një periudhe kohe të caktuar, çka e ndryshon gjendjen e vetë aggregate, duke kaluar nga një lëndë plastike në lëndë të ngurtë. Shkaqet për ndodhjen e këtyre

ndryshime janë proceset shumë të ndërlikuara fizike – kimike që zhvillohen në marrëdhënien e çimentos me ujin, e njohur si **hidratim të çimentos**.

Proçesi i hidratimit fillon disa minuta pas përzierjes të çimentos dhe ujit dhe në etapën e parë e cila zgjatë rreth 5 deri 10 orë, brumi i çimentos gradualisht ngurtësohet – lidhet dhe pastaj krijohet ngurtësimi gradual. Studime të ndryshme teorike dhe praktike kanë treguar se për hidratimin e tërësishëm të çimentos është i nevojshëm sasi e saktë ujit, përcaktuar në vartësi nga lloji dhe përbërja e çimentos.

Shpejtësia e hidratimit varet nga një numër i madh i faktorëve, të tillë si:

- përbërja minerale e çimentos,
- cilësia e bluarjes të çimentos,
- sasia e ujit,
- temperatura e rrethinës/ambientit rrethues,
- etj.

b) Uji.

Uji në formën e tij të pastër, është lëng pa shije dhe pa erë po ashtu dhe pa ngjyrë. Duket i pangjyrë në sasi të vogla për syrin tonë, megjithëkëtë mund të shihet si i kaltër në sasi të mëdha ose me vegla shkencore. Uji është lëngu më i përhapur në toke. Formula kimike e tij është H_2O . Uji është në ekuilibër dinamik midis gjendjes së gaztë dhe asaj të lëngët në temperaturë dhe trysni standarde. Uji në vetvete është pa shije dhe pa ngjyrë por në kontakt të gjatë me ajrin lidhet me dioksidin e karbonit (CO_2) dhe merr një shije të athët acidi karbonik që nuk është i mirë për shëndetin. Ai është i domosdoshëm për të gjitha format e jetës dhe njihet edhe si tretësi më i gjithanshëm. Pa të, jeta siç e njohim ne, do të ishte e pamundur.

Uji është një tretës shume i mirë dhe tret shumë lloje substancash. Ndryshe mund të quhet tretës universal. Substancat që treten mirë në ujë quhen hidrofilike ndërsa, ato që nuk treten mirë në ujë, quhet hidrofobike. Uji është tretësi më i mirë (universal) falë strukturës së molekulës së tij që është dipolare.

Uji i përshtatshëm për t'u pirë nga njeriu quhet ujë i pijshëm. Uji që nuk është i përshtatshëm për t'u pirë, por që nuk është i rrezikshëm për njerëzit quhet ujë i sigurt.

c) Shtesa speciale - aditivë.

Aditivët paraqesin shtesa të veçanta me të cilat mund të përmirësohen disa veti të betonit të freskët dhe të ngurtësuar siç janë përpunueshmëria, vendosshmëria-shtruarja e betonit, pa depërtueshmëria e ujit etj.

V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Zhvillimi disa vjeçar i aktivitetit të prodhimit të impiantit të betonit, ka bërë të mundur identifikimin e disa ndikimeve negative në zonën e zhvillimit të punimeve si dhe në afërsi të saj.

5.1.Shkarkime në ajër.

Zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të betonit, shoqërohet me shkarkime në ajër të gazeve dhe pluhurit.

Burimi i shkarkimit të këtyre gazeve është nga puna e mjeteve ngritëse e transportuese, si rezultat i djegies lëndë së lëndës djegëse naftë ose benzinë.

Në përbërje të gazeve që shkarkohen janë: bioksidi i squfurit (SO_2), monoksid i karbonit (CO), gazi karbonik (CO_2), oksid i azotit dhe komponime të tjera të tij (NO_x), përbërës të tjerë të avullueshëm etj.

Krahas shkarkimit të gazeve, kemi edhe shkarkim të pluhurit gjatë zhvillimit të proceseve të shkarkimit të inerteve, çimentos etj. por edhe prej lëvizjes së mjeteve ngritëse e transportuese të materialeve brenda teritorit ku zhvillohet kjo veprimtari.

5.2.Shkarkime në tokë.

Zhvillimi i proceseve të prodhimit të betonit në raste specifike, krijon shkarkime të mbetjeve të ngurta të cilat përbëhen kryesisht prej inerteve, çimentos etj. Të gjitha këto lëndë nuk klasifikohen tek lëndë të rrezikëshme, sipas legjislacionit aktual të vendit tonë. Këto mbetje teknologjike qëndrojnë përkohësisht në vende të caktuara për to, deri në momentin e ripërdorimit në procesin teknologjik të prodhimit të një marke të caktuar betoni. Treguesit cilësor të lëndëve apo materialeve që përbëjnë mbetjet teknologjike, koha e kufizuar e qëndrimit të tyre në vendepozitimin e përkohëshëm, japin impakte minimale në tokë, në vendin e ku ato qëndrojnë.

Veprimtari e prodhimit të betonit dhe të tjera veprimtari që zhvillon ky subjekt në këtë teritor, shoqërohen edhe me krijimin e mbetjeve të ngurta urbane, të cilat përbëhen kryesisht prej ambalazheve të letrës e kartonit, plastikës, metalit etj.

Në një vendin të caktuar, të shtruar me beton, janë vendosur kazanët e mbledheve të mbetjeve urbane të krijuar gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie. Këto mbetje largohen çdo ditë, nga ky vend duke u hedhur në kazanët e mbetjeve urbane të zonës. Kështu që influenca e këtyre mbetjeve në cilësinë e tokës është minimale për të mos thënë që nuk egziston.

Në katalogun shqiptar të klasifikimit të mbetjeve të ngurta, V.K.M.-së Nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, nuk përfshihet veprimtari e prodhimit të betonit dhe mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të saj. Duke vlerësuar të gjitha kategorizimet e mbetjeve të ngurta, të përcaktuara në këtë VKM, dhe llojet e mbetjeve të ngurta të gjeneruara gjatë procesit të prodhimit të betonit, në vijim po japim të dhënat respektive:

01 MBETJE QË DALIN NGA KËRKIMET E SHFRYTËZIMI I MINIERAVE DHE KARRIERAVE, SI EDHE NGA TRAJTIMET FIZIKO - KIMIKE TË MINERALEVE.

01 03 08 Mbetje pluhurash, përveç atyre të përmendura në rubrikën 01 03 07

01 04 08 Mbetje zhavorri dhe mbetje gurësh të tjera nga ato të përmendura në 01 03 07

01 04 09 Mbetje rërash dhe argjilash

01 04 10 Mbetje pluhurash, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07

5.3.Shkarkime të ujërave të ndotur.

Këtu kemi, shkarkime të ujërave sipërfaqësore gjatë reshjeve të shiut si dhe shkarkime të rastësishme të ujërave gjatë proceseve të ndryshme pune. Këto ujëra mbartin me vete grimca të ngurta të inerteve si dhe çimento. “Ndotja” e ujërave sipërfaqësore mund të ndodhë nga:

- a) Pastrimi i ambjentit ku është instaluar impjanti i prodhimit të betonit, në rastet e shkarkimit të materialeve që përpunohen aty, nga avari të ndryshme teknike,

b) Ujrat e përdorura për qëllime sanitare.

Ujërat derdhen në një vaskë dekantuese dhe më tej në ujërat e një prroske, e cila rrjedh disa metra larg kufirit jugor të objektit.

Në rrjetin e kanalizimeve shkarkohen vetëm ujërat që dalin nga ambientet hidro-sanitare dhe që përmbajnë kryesisht ujëra të zeza. Ujërat e zeza derdhen në gropë septike.

5.4.Shkarkime të zhurmave.

Gjenerimi i zhurmave ndodh gjatë proceseve të shkarkimit të inerteve si dhe të punës së impjantit të prodhimit të betonit dhe të lëvizjes së mjeteve të transportit.

Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 80 dBA.

VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.

Objekti ku ndodhet impianti i betonit është i përfshirë brenda koordinatave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

X	Y
X1 = 4373517.546	Y1 = 4483147.046
X2 = 4373594.555	Y2 = 4483146.173
X3 = 4373594.660	Y3 = 4483056.550
X4 = 4373457.084	Y4 = 4483051.107

Trualli i pazënë me ndërtime nuk ka asnjë lloj funksioni apo përdorimi. Në të ka elementë infrastrukturë si rrjete furnizimi me ujë të pijshëm, rrjete të shkarkimit të ujrave të ndotur, rrjete rrugore etj. Ky teritor është jashtë planeve të pushtetit për ndërtimin e objekteve të banimit si dhe infrastrukturës dhe elementëve të saj.

a. Përshkrim të faktorëve klimatikë.

Zona që ne vlersojmë bën pjesë në ndarjen klimatike mesdhetare paramalore. Veçoritë e klimës në këtë zonë kushtëzohen nga ndikimi i fuqishëm i detit Jon.

Temperature mesatare vjetore është rreth 17°C, temperature e Janarit si muaji më i ftohtë është 10°C, dhe e korrikut si muaji më i nxehtë është 25°C.

Zona karakterizohet nga rredhje atmosferike të konsiderushme të nivelit 1000-2000 mm, kryeshit në formë shiu. Regjimi i reshjeve të shiut është tipik i karakterit mesdhetar me maksimum në periudhën e dimrit dhe minimum në atë të verës.

Kushtet klimatike janë të përshtatshme në përgjithësi për zhvillimin bujqësor dhe blektorial. Gjithashtu një klimë e tillë ndikon pozitivisht edhe mbi shëndetin e njeriut.

b. Përshkrim i përgjithshëm i gjeologjisë të zonës.

Në zonën tonë të studimit dhe përgjithësisht në të gjithë zonën nga Vlora dhe deri në Borsh, kemi depozitimet triasike të gëlqerorëve të mbivendosur mbi pakon paleogjenike të argjiliteve e ranorëve si dhe depozitimet Kuaternare të përfaqesuara nga deluvione shpati dhe rëra aluviale detare. Depozitimet e Triasikut të sipërm kanë përhapje vetëm në pjesën jug-perëndimore të zonës Jonike. Ato ndërtojnë bërthamat e strukturave antiklinale të Malit të Gjërë, Fterrës, Çikës, Tragjasit, etj.

Litologjikisht përfaqësohen nga dolomite diagjenetike masive kristalore, në pjesën e poshtme të ndërthurura me dolomite brekçore e gëlqerorë dolomitikë. Në pjesën e sipërme predominojnë dolomite e gëlqerore dolomitikë shtresorë. Vende-vende dolomitet janë shtresorë kompaktë dhe në vende të tjera me pamje ranorike të shkrifet.

Në zonën Jonike, nga studimet dhe punimet e kryera në depozitimet paleogjenike janë veçuar ato të Paleocenit, Eocenit, Oligocenit të poshtëm, Oligocenit të mesëm dhe Oligocenit të sipërm.

Gjeomorfologjia dhe morfologjia e zonës së studiuar është e lidhur ngushtë me gjeologjinë. Ajo përfaqëson një zone që ne gjatë intervalin ku shtrihet zona e studiuar, është e ndërtuar nga shkëmbinj sedimentare. Në këtë zonë janë krijuar shumë lugina erozionale dhe përroska të shumta me dhe pa ujë, të cilat shkarkojnë ujërat e tyre nga mali në det Adriatik. Këndi i shpateve të maleve shkon nga 20° -25° deri në 35° -40° dhe disa raste është më shumë. Nga rikonicioni i bërë në vend, shihet se, një pjesë e mirë e zonës së studiuar përbëhet nga shkëmbinj me gërryerje të shumta, të cilat përgjithësisht janë e mbushur me depozitime deluviale dhe aluviale me trashësi të ndryshme nga 1.0-2.0 m deri 3.5.0-5.0 m.

Fenomenet fiziko gjeologjike dinamike negative më kryesore dinamike që sjellin probleme qëndrueshmërie që kërcënojnë zonat bregdetare janë: • Rrëshqitjet, • Erozioni, • Përmbytja, • Tërmetet etj.

c. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore të zonës.

Rrjeti hidrik i këtij rajoni përfaqësohet vetëm nga përrenj/prosak të karakterit stinor, ujrë e të cilëve derdhen në det. Duke qenëse kemi të bëjmë me një strukturë truallë nga depozitime gëlqerorësh përgjithësisht me strukturë poroze, lehtësisht të përshkrueshme nga uji, ujrë e reshjeve të shirave depërtojnë edhe nëntokë dhe, për këtë arsye shumica e proskave nuk kanë shtrat të përhershëm.

d. Bimësia.

Të dhënat mbi florën dhe faunën e bregut të Jonit dëshmojnë për mbi 130 lloje algash makrofite, 250 lloj peshqish etj.

Fusha livadhet dhe pyjet e kësaj zone, ofrojnë mjedise të favorshme për rritjen e bimëve dhe të kafshëve të llojeve të ndryshme. Në këtë zonë ndesheme me drufrutorë të zonës së mesdheut, kryeshit agrume dhe ullinj. Por edhe vreshtat zënë vend të rëndësishëm.

Në zonën e shkurreve ndeshemi me bimë barishtore dhe etero vajore që shërbejnë në mjeksinë popullore dhe farmaceutike ndër të cilat mund të përmendim valanin dhe perrallin të njohura për vlerat e tyre kurative.

Në lartësitë mbi 800 m gjendet pisha dhe bredhi i detit, bushi, shtogu, dushku etj.

Fauna e zonës është e pasur me lloje të ndryshme gjallesash, duke përfshirë këtu sorkadhen, derrin e egër, ujkun, çakallin, dhelprën, lepurine e egër etj. Krahës tyre takojmë edhe harabelin, qukapikun, mëllenjën, zhgabën, thëllëzën etj.

e. Cilësia e ajrit në zonë.

Zona në të cilën zhvillohet kjo veprimtari është një zonë rurale, e cila ka marrë një zhvillim të vlersuar në drejtim të zhvillimit të aktivitetit të turizmit. Pavarësisht këtij fakti, në tërësi kjo zonë duhet vlerësuar si një zonë rurale me, tregues cilësorë përgjithësisht normal të ajrit, ujirave siparfaqësore dhe ndotjes së tokës.

Në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitin 2023, pasqyruar në faqen zyrtare të AKM-së, nuk paraqiten të dhëna zyrtare mbi cilësinë e ajrit, ujrave dhe të tokës si dhe tregues të tjerë mjedisor për Rrethin e Vlorës dhe konkretisht, teritorin e zonës së Himarës në të cilin ushtrohet ky aktivitet.

f. Nivel i zhurmave në zonë.

Në lidhje me nivelin e gjenerimit të zhurmave, duhet të tregojmë të njëjtat vlerësime si më lart. Kemi të bëjmë me një zonë me zhvillim bujqësor dhe me një zhvillim të vlersuar në drejtim të zhvillimit të aktivitetit të turizmit.

Në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitin 2023, pasqyruar në faqen zyrtare të AKM-së, nuk paraqiten të dhëna zyrtare mbi nivelin e zhurmave si dhe tregues të tjerë mjedisor për Rrethin e Vlorës në të cilin ushtrohet ky aktivitet.

g. Administrimi i mbetjeve në zonën e projekti.

Bashkia e Vlorës ka të organizuar shërbimin e largimit të mbetjeve urbane nga qendrat e banuara në një venddepozitimi të tyre. Ky shërbim shtrihet edhe në zonën ku zhvillohet ky projekt.

h. Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti.

Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti, është Bashkia Vlorë

VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.

Eksperienca disa vjeçare e veprimtarisë së prodhimit të betonit ka treguar se ka gjenerim të zhurmave si dhe menaxhim të mbetjeve të ngurta teknologjike përfshi këtu edhe të mbetjeve urbane.

7.1. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritëshme, në mjedis.

a. Shkarkime në ajër.

Zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të betonit, shoqërohet me shkarkime në ajër të gazeve dhe pluhurit.

Burimi i shkarkimit të këtyre gazeve është nga puna e mjeteve ngritëse e transportuese, si rezultat i djegies lëndë së lëndës djegëse naftë ose benzinë.

Në përbërje të gazeve që shkarkohen janë: bioksidi i squfurit (SO_2), monoksid i karbonit (CO), gazi karbonik (CO_2), oksid i azotit dhe komponime të tjera të tij (NO_x), përbërës të tjerë të avullueshëm etj.

Krahas shkarkimit të gazeve, kemi edhe shkarkim të pluhurit gjatë zhvillimit të proceseve të shkarkimit të inerteve, çimentos etj. por edhe prej lëvizjes së mjeteve ngritëse e transportuese të materialeve brenda teritorit ku zhvillohet kjo veprimtari.

b. Gjenerimi i zhurmave.

Gjenerimi i zhurmave ndodh gjatë proceseve të shkarkimit të inerteve si dhe të punës së impiantit të prodhimit të betonit dhe të lëvizjes së mjeteve të transportit.

Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 80 dBA.

c. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta teknologjike dhe mbetjeve urbane.

Zhvillimi i proceseve të prodhimit të betonit në raste specifike, krijon shkarkime të mbetjeve të ngurta të cilat përbëhen kryesisht prej inerteve, çimentos etj. Të gjitha këto lëndë nuk klasifikohen tek lëndë të rrezikëshme, sipas legjislacionit aktual të vendit tonë. Këto mbetje teknologjike qëndrojnë përkohësisht në vende të caktuara për to, deri në momentin e ripërdorimit në procesin teknologjik të prodhimit të një marke të caktuar betoni. Treguesit cilësor të lëndëve apo materialeve që përbëjnë mbetjet teknologjike, koha e kufizuar e qëndrimit të tyre në vendepozitimin e përkohëshëm, japin impakte minimale në tokë, në vendin e ku ato qëndrojnë.

Veprimtari e prodhimit të betonit dhe të tjera veprimtari që zhvillon ky subjekt në këtë teritor, shoqërohen edhe me krijimin e mbetjeve të ngurta urbane, të cilat përbëhen kryesisht prej ambalazheve të letrës e kartonit, plastikës, metalit etj.

Në një vendin të caktuar, të shtruar me beton, janë vendosur kazanët e mbledheve të mbetjeve urbane të krijuar gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie. Këto mbetje largohen çdo ditë, nga ky vend duke u hedhur në kazanët e mbetjeve urbane të zonës. Kështu që influenca e këtyre mbetjeve në cilësinë e tokës është minimale për të mos thënë që nuk egziston.

Në katalogun shqiptar të klasifikimit të mbetjeve të ngurta, V.K.M.-së Nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, nuk përfshihet veprimtari e prodhimit të betonit dhe mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të saj. Duke vlerësuar të gjitha kategorizimet e mbetjeve të ngurta, të përcaktuara në këtë VKM, dhe llojet e mbetjeve të ngurta të gjeneruara gjatë procesit të prodhimit të betonit, në vijim po japim të dhënat respektive:

01 MBETJE QË DALIN NGA KËRKIMET E SHFRYTËZIMI I MINIERAVE DHE KARRIERAVE, SI EDHE NGA TRAJTIMET FIZIKO - KIMIKE TË MINERALEVE.

01 03 08 Mbetje pluhurash, përveç atyre të përmendura në rubrikën 01 03 07

01 04 08	Mbetje zhavorri dhe mbetje gurësh të tjera nga ato të përmendura në 01 03 07
01 04 09	Mbetje rërash dhe argjilash
01 04 10	Mbetje pluhurash, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07

d. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.

Nuk vlersohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Në këtë objekt kanë përfunduar ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjerie, rrugësh etj.

Në periudha të përcaktuara, kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjerie, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

e. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804, dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundshme” për t’u shpallur “Peisazh i mbrojtur”.

f. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokës shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e mësipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të impiantit të prodhimit të betonit nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujërave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

7.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.

a. Vlerësimi i ndikimeve.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerie egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.

- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimeve të identifikuara. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohë zgjatjen e çdo lloj ndikimi të identifikuar.
- Përafron ato me objektivet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapësinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim.

c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkoshëm.

d. Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparëshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe regjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

e. Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërme dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimit të identifikuar.

f. Llojet e ndikimeve të identikuara (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit të implantit të prodhimit të betonit, janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këtë linjë teknologjike, gjykojmë se ato duhet të realizojnë qëllimin për të cilën janë vendosur dhe funksionojnë në këtë proces teknologjik. Vënia plotësisht në punë e tyre për një periudhë relativisht të gjatë kohe, si dhe kryerja e monitorimeve respektive minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analiza e të cilave do të dëshmojë për:

- i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesëshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;
- ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.

Vlerësimi i përgjithshëm i zhvillimeve në këtë veprimtari dëshmon se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohëshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të secilës prej tyre nuk kanë influenca mbetëse në cilësinë e mjedisit dhe nuk mund të çojnë më tej në përkeqësim të treguesve cilësorë aktualë të mjedisit.

IX. ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjerie të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.
- Gjenden lehtësisht persona të kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluar si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

X. MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME).

Drejtuesit teknik dhe ligjor të subjektit i kanë kushtuar vemendje maksimale eliminimit të të gjitha llojeve të mbetjeve të krijuara nga kjo veprimtari. Në vijim po përshkruajmë mënyrat apo procedurat që zbatohen në trajtimin e mbetjeve të krijuara.

- a. Mbetje e teknologjike të ngurta që dalin gjatë proceseve teknologjike.

Zhvillimi i proceseve të prodhimit të betonit në raste specifike, krijon shkarkime të mbetjeve të ngurta të cilat përbëhen kryesisht prej inerteve, çimentos etj. Të gjitha këto lëndë nuk klasifikohen tek lëndë të rrezikëshme, sipas legjislacionit aktual të vendit tonë. Këto mbetje teknologjike

qëndrojnë përkohësisht në vende të caktuara për to, deri në momentin e ripërdorimit në procesin teknologjik të prodhimit të një marke të caktuar betoni.

- b. Mbetje urbane të cilat përbëhen nga ambalazhe të letrës, kartonit, plastikës, qelqit, mbetje ushqimore nga veprimtaria njerzore etj.

Zhvillimi i kësaj veprimtarije shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë, të cilat janë në formë të mbetjeve të letrës, kartonit, plastikës etj.

Mbetje të letrës, kartonit, plastikës etj., çohen për çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të zonës dhe largohen prej andej për në vendin e kontraktuar nga bashkia Vlorë.

XI. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluar në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit Europian, kryesisht në Itali. Janë pajisje bashkëkohore me sisteme të komandimit individual të punës së tyre, sepse i tillë është edhe operacioni i punës së tyre. Kështu çdo njëra prej tyre punon sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa cënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të tjera. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjie të kontrolluar në nivelet më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorrëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim efiçent të energjisë elektrike.

Sistemi i ndriçimit të ambjenteve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim efiçent të energjisë elektrike.

XII. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë relativisht të gjatë kohe që ushtron këtë veprimtari, në shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse. Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë.

Ne vlerësojmë se është e nevojshme plotësimi i këtyre rregulloreve me ato të mbrojtjes nga zjarri si dhe të manovrimeve që duhet të kryhen në rastet e ndodhjes së aksidenteve të ndryshme, teknike e teknologjike.

Krahas tyre duhet të vijojë trajnimi i punonjësve të këtij subjekti për njohjen e plotë të të gjitha rregulloreve të hartuara.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjerike (ndërtesë, rrjete inxhinjerike etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana finaciare ashtu edhe në prespektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojnë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe, për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarije.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundëshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohëshme të aktivitetit prodhues në këtë linjë teknologjike. Këto ndërprerje janë të zakonshme, nisur nga organizimi i punës vetëm me një turn dhe me ditë pushimi javor dhe të të gjithë festave zyrtare.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedura të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkojnë studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit finaciari, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahës kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do hidhen mbeturinat që krijohen, metalike, plastike gome, druri, vajrash, inertesh etj. Çdo të bëhet me truallin pas lirim të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarije nuk sjell pasoja në ndjeshmësi në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluar. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.


Gjithmone prane jush!

XIII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Monitorimet duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar për vlerësimin e shkarkimeve në mjedis, në përputhje me kërkesat e lëggjislacionit respektiv, për shkarkimet e pluhurave në ajër, për shkarkimet e ujërave në rrjetin e kanalizimeve dhe nivelin e zhurmave.

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Aksesi në vendodhjet e matjeve
Shkarkimi i pluhurave në ajër	Çdo 6 muaj	Gjatë magazinimit të inerteve të çimentos si dhe procesit të prodhimit të betonit
Niveli i zhurmave	Çdo 6 muaj	Në impiantin e prodhimit të betonit
Shkarkimet e ujërave në rrjetin e kanalizimeve	Çdo 6 muaj	Ujërat e pastrimit

-FUND-



LOERMA SHPK

Laboratori i Akredituar
Gjithmone prane jush!